

Prot.No. ALB-GM-23-004

Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë

Dhe

SICPA Security Solutions Albania Sh. p. k.

Dhe

SICPA SA

KONTRATË SHITESË PËR NDRYSHIMIN E KONTRATËS SË
KONCESIONIT NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCIVE DHE
EKONOMISË, SI AUTORITET KONTRAKTUES, DHE SHOQËRIVE
"SICPA SECURITY SOLUTIONS S.A." E "SICPA SECURITY
SOLUTIONS ALBANIA SH.P.K", "PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN,
DIZENJIMIN, PRODHIMIN DHE NGRITJEN E NJË SISTEMI PËR
EMETIMIN, SHPËRNDARJEN, GJETJEN DHE MONITORIMIN E
PULLAVE FISKALE E TË PULLAVE TË KONTROLLIT TË
BARNAVE", TË MIRATUAR ME LIGJIN NR.10381, DATË 24.02.2011

 RB SSK

Kjo Kontratë Shtesë, nënshkruhet sot më 24.1.2023 në Tiranë, Shqipëri

NDËRMJET:

- (1) **MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË** (më poshtë referuar si "Autoriteti"), Blvd. "Dëshmorët e Kombit", Nr.3, Tiranë, Shqipëri, në emër të Republikës së Shqipërisë,
- (2) **SICPA SECURITY SOLUTIONS ALBANIA SH.P.K.** (më poshtë referuar si "SICPA Albania"), një shoqëri Shqiptare e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër L02120032R, me seli qendrore në Rrugën "Gryka e Kaçanikut", Autostrada Tiranë-Durrës, km 5, Kati 4, Tiranë, Shqipëri dhe
- (3) **SICPA S.A.** (më poshtë e referuar si "Mëma"), një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit Zvicerian me seli në 41 Avenue de Florissant, 1008 Prilly, Zvicër.

Secila një "Palë" dhe së bashku "Palët"

KU:

- (A) Palët kanë lidhur një Kontratë Koncesioni mbi Krijimin dhe Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Pullave Fiskale të miratuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin nr. 10381 datë 24.2.2011 ("Kontrata e Koncesionit"); dhe
- (B) Palët kanë rënë dakord për të bërë disa ndryshime në Kontratën e Koncesionit.

PIKA 1 - NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT

- a) Neni 3.2 i Kontratës së Koncesionit do të ndryshohet si më poshtë:

"3.2 Koncesioni jepet për një periudhë që fillon në Datën Efektive dhe mbaron më 31 dhjetor 2024 ("Afati"); me kusht që, nëse kjo Kontratë përfundon më shpejt sipas kushteve të saj, "Afati" do të nënkuptojë dhe do të kufizohet në periudhën që fillon në Datën Efektive dhe mbaron në datën e përfundimit të kësaj Kontrate, në përputhje me termat e saj."

- b) Palët bien dakord se çmimet për njësi të produkteve të referuara në pikën 17.1 të Kontratës së Koncesionit do t'u aplikohet një zbritje prej 10%, duke filluar nga data 07.02.2023.
- c) Në Aneksin 1 të Kontratës së Koncesionit bëhen ndryshimet si vijon:

- a. "Produkte(t) quhen produktet e duhanit, produktet e distiluara dhe të fermentuara të alkolit duke përfshirë birrën, dhe produkte të tjera që i shtohen qëllimit të Shërbimeve kohë pas kohe në përputhje me Nenin 3.6 të kësaj Kontrate";

- b. Fshihet çdo reference e bërë lidhur me "Produktet Farmaceutike".
- d) Çdo përcaktim apo referencë tjetër në Kontratën e Koncesionit për Produktet Farmaceutike fshihet.

PIKA 2 - DETYRIME E ANGAZHIME TË TJERA MES PALËVE

- a) Palët deklarojnë se heqin dorë në mënyrë të përvokueshme nga çdo pretendim, apo kërkesë lidhur me Produktet Farmaceutike, bazuar në Kontratën e Koncesionit.

SICPA Albania dhe Mëma deklarojnë se nuk kanë shfaqur apo pretenduar dhe nuk do të kenë në të ardhmen asnjë pretendim apo kërkesë ndaj Autoritetit për zbatimin e produkteve të tjera objekt i Kontratës së Koncesionit të miratuar me Ligjin Nr.10381 datë 24.02.2011.

- b) SICPA Albania dhe Mëma angazhohen për vazhdimin e teknologjisë aktualisht të implementuar bazuar në Kontratën e Koncesionit, me disa përmirësime teknologjike në fushat e gjykuara si të detyrueshme për funksionalizimin e duhur të saj në thelbin operacional dhe në terren, e konkretisht duke realizuar:
- a. Përmirësime të caktuara, nëse janë të nevojshme, të platformës ekzistuese – CAPEX i kufizuar, për të lejuar funksionalizimin dhe operimin e efektshëm të teknologjisë/sistemit aktual.
 - b. Nisjen e modulit të ri të raportimit të Shërbimeve të të Dhënave që i mundëson Autoritetit më shumë analitikë përshkruese duke u fokusuar në atë që ndodhi në të kaluarën, analitikë diagnostike që ndihmon në zbulimin e arsyes se pse ndodhën gjërat dhe analitikë parashikuese që mundësojnë parashikimin e asaj që ka të ngjarë të ndodhë në të ardhmen – aktivizimi + integrimi në platformën ekzistuese.
 - c. Asistencë teknike tek Autoriteti me të gjithë ekspertizën teknologjike dhe operacionale të ekspertëve të Mëmës për vijueshmërinë dhe funksionimin e sistemit të pullave fiskale, 7 muaj para përfundimit të Afatit.
- c) Palët angazhohen të punojnë së bashku të zbatojnë aktivizimin digjital të pullave fiskale në momentin që paguhen detyrimet e akcizës bazuar në Procedurën e Ndryshimit të Kontrollit të përcaktuar në Aneksin 16 të Kontratës së Koncesionit. Kërkesa përkatëse për Ndryshim do të bëhet nga Autoriteti jo më vonë se 10 ditë pas nënshkrimit të kësaj Kontratë Shtesë. Afatet e zbatimit do të përcaktohen brenda Vlerësimit të Impaktit sipas nenit 7 të Aneksit 16, dhe mund të ndryshojë sipas Produktit.

Handwritten signature and initials, possibly 'LB' and 'SSH', in black ink.

PIKA 3 - TË PËRGJITHSHME

Kjo Kontratë Shtesë hyn në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të ligjit që miraton këtë Kontratë.

...

NË DËSHMITË nënshkruar të kësaj Kontratë Shtesë, rregullisht nga Palët.

Nënshkroi për dhe në emër të
MINISTRISË SË FINANCËVE DHE
EKONOMISË TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Nënshkrimi.....

Emri: Delina Ibrahimaj

Pozicioni: Ministre e Financave dhe Ekonomisë ("Autoriteti")



NËNSHKROI për dhe në emër të
SICPA SECURITY SOLUTIONS
ALBANIA SH. P. K.

Nënshkrimi.....

Emri: Samir Shqarri

Roli: Administrator



NËNSHKROI për dhe në emër të
SICPA S.A.

Nënshkrimi.....

Emri: Rikind Bytyqi

Roli: Përfaqësues me Prokurë